



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “InterAdria LLC” të datës 05.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 31.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje teknologjike (IT, shkencë) për kabinete në IEAA” me nr. të prokurimit 616-23-9220-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “InterAdria LLC” të datës 05.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 31.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje teknologjike (IT, shkencë) për kabinete në IEAA” me nr. të prokurimit 616-23-9220-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “InterAdria LLC” (tutje “parashtruesi”) me datë 05.08.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 31.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje teknologjike (IT, shkencë) për kabinete në IEAA” me nr. të prokurimit 616-23-9220-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Ky arsyetim nuk qendron per faktin se znj. Shpresa Dragusha ka perfunduar Masterin e Shkencave te Inxhinierise Elektrike me 03. Janar 2018 I bie qe deri ne daten e Publikimit te Dosjes se tenderit me 30.08.2023 znj. Shpresa I ka 5 vite e 7 muaj pervoje pune. Gje qe ne si OE e kemi deshmuar me Diplomen e znj. Shpresa Dragusha si dhe CV. Pretendimit se permes CV-se se dorzuar nuk eshte deshmuar puna profesionale ne lemin e kerkuar ne prape kontestojme arsyetimin tuaj duke u bazuar ne ate se znj. Shpresa Dragusha ne Janar 2018 deri ne Prill te 2019 ka qene Product Manager for Cisco Products ne kompanine ITD Prishtina, ndersa nga Prill 2019 e tutje Shpresa Dragusha eshte e angazhuar ne kompanine InterAdria LLC ne cilesin System Integrator and Presales Engineer. Pra, nga Janar 2018 deri ne momentin e publikimit te njoftimit per tender znj. Shpresa Dragusha ka me shume se 5 vite pervoje pune profesionale. Ne kemi ofruar po te njejtin model qe keni kerkuar pra Bose QuietComfort 45 headphones use a lithium-ion rechargeable battery that provides up to 22 hours* of audio playback with noise cancelling turned on, qe jane Bluetooth Version 5.1 gje qe edhe ne keni ofruar po te njejtin produkt sic mund te shihni edhe ne dokumentin e dorzuar nga ne Oferta Teknike si dhe broshuren faqe 26 te dokumentit Broshurat IEAA".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

Sipas Vendimi i OSHP-se me nr:OSHP2024/0049. Ju si OE-ik tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 ku i është kërkuar qe Operatori Ekonomik duhet te dëshmoj se ka nje bachelor apo inxhinier te elektrikes apo elektroteknikes me përvoje pune min. 5 vite- Përmes CV-së se dorëzuar për këtë pike te kërkesës nuk është deshmuar puna profesionale ne lemin e kërkuar.

Tek kërkesa tjetër për Head Phone është kërkuar bluetooth verzioni 5.3 ndërsa OE-ik ka ofertuar me versionin 5.1 e qe është ne kundërshtim me kërkesat e DT-se.

Nuk e plotëson kriterin e kërkuar sipas kërkesë se AK-se

Sa i përket inxhinierit të elektrikës apo elektroteknikës, nga oferta e parashtruesit është gjetur se parashtruesi nuk e ka dorëzuar diplomën e noterizuar, CV nuk është e nënshkruar nga punonjësi. Mbi të gjitha kontrata e punës së punonjësës me InterAdria LLC është lidhur përmes vërtetimit të nënshkrimit te noteri me datë 06.11.2023. Në anën tjetër në CV e punonjësës thuhet se e njëjta punon për InterAdria LLC që nga muaj prill i vitit 2019. Pra të dhënat në CV nuk përputhen me kontratën e punës së dorëzuar. Në CV po ashtu thuhet se punonjës ka punuar që nga viti 2017 edhe si zyrtare financiare "Financial Accountant" për një firmë me emrin "Bioteknik Laboratory". Mirëpo kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë për inxhinier të elektrikës apo elektroteknikës me përvojë të punës profesionale min. 5 vite pas diplomimit. Duke marrë parasysh se diploma e punonjësës është marrë me datë 3 janar 2018. Në këtë mënyrë është gjetur se CV nuk i përmbushë kërkesat e DT. Vlen të theksohet që sipas UPP në rastet kur CV nuk i përmbushë kërkesat e DT, tenderi refuzohet si i papërgjegjshëm pa pasur nevojë që të kërkohen fare sqarime shtesë. Prandaj pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Sa i përket kërkesës për headphone me bluetooth me version 5.3, AK i ka falur besimin e plotë komisionit vlerësues në raportin e të cilit është gjetur se parashtruesi nuk ka ofertuar me versionin e kërkuar. Rrjedhimisht nuk është përmbushur kërkesa e DT. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 12.08.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.